



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

05. nr. 81/2011

Raporti i punës për vitin 2011

I DREJTORISË PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

DHJETOR

RAPORT

I PUNËS NË DREJTORINË PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM **Për vitin, 2011**

Në bazë të planit vjetor të punës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, kjo drejtori është angazhuar.

Duke u nisur nga kompetencat e komunës në fushën e Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e tjera të parapara me Ligjin për Mbrojtje dhe Shpëtim, si dhe në bazë të planit të punës të kësaj drejtorie janë kryer gati të gjitha detyrat e parapara me planin e punës, përveç detyrave të cilat janë bart për këtë vit për arsye se kanë qenë të planifikuara ashtu.

Këtë vit ka vazhduar planifikimin sipas Udhëzimit Administrativ nr. 19/2008 për Metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut dhe Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Të gjitha planet të cilat deri më tani kanë qenë të hartuara nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim janë duke vazhduar punën në kompletimin dhe azhurimin me shënime të reja, në bazë të statistikave të raporteve mujore. Meqë në këtë vit është kryer edhe regjistrimi i popullatës dhe tani kemi shënime të reja, tani gati të gjitha planet duhet të azhurohen me shënime të reja.

Qëllim i drejtorisë ka qenë krijimi i prioritetëve dhe caktimi i detyrave sipas dinamikës së punës për koordinimin sa më efikas të drejtorisë me subjektet relevante të të gjitha niveleve, të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejt dhe në mënyrë profesionale në raste të fatkeqësive natyrore dhe katastrofave tjera të mundshme, si dhe koordinimi i ekipeve emergjente, subjekteve përkatëse në menaxhimin e situatave emergjente.

Dinamika e punës në këtë vit është realizuar në DMSH-im sipas planifikimit të punës për vitin 2011, dhe kontrolluar nga DME-së.

Grupi punues profesional prej 12 anëtarëve, duke u bazuar në Udhëzimin administrativ për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut dhe Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim, vazhdon punën sipas lëmive në kompletimin e dokumentacionit të planeve ekzistuese.

Pjesa dërrmuese e vlerësimit të rrezikut është kryer deri më tani, parashihet sipas Planit të punës të DME-te që ky dokument të punohet deri në fund të këtij viti me qëllim të mbledhjes së shënimeve sa më të sakta në secilën lëmi.

Qëllimi i këtyre planeve është:

Që komuna e Vushtrrisë të përgatitet për të parandaluar, reaguat, rimëkëmbur nga fatkeqësitë dhe katastrofat natyrore dhe teknike. Misioni ynë ka për qëllim krijimin e bazës metodologjike dhe profesionale për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në parandalimin,

zvogëlimin dhe sanimin e dëmeve të shkaktuara nga katastrofat dhe fatkeqësitë tjera të mëdha natyrore, të cilat me efekte të menjëhershme do të shkaktonin dëme në popullatën civile, pronën e tyre, në mjedis, trashëgimin kulturore etj

- Që të bëhet koordinimi i të gjitha shërbimeve për reagim emergjent në nivel komunal si dhe asistimi i popullatës civile në rast të fatkeqësive natyrore, teknologjike dhe fatkeqësive të tjera;

- Që të kemi një strukturë të koordinuar civile, shërbimet emergjente në kuadër të komunës (shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, shërbimin emergjent komunal medicinal, kryqi i kuq, OJQ-të) SHPK-ës, në mënyrë që këto struktura të jenë të gatshme të reagojnë shpejt dhe me efikasitet në raste emergjente civile.

Me këto struktura jemi në kontakt të përhershëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste emergjente. Këto kontakte bëhen në mënyrë të rregullt (24 orë pa ndërprerë), me radiolidhje dhe telefon fiks.

Futja në funksion e kapaciteteve ekzistuese të komunës për situata emergjente konsiderohet shumë e rëndësishme, andaj kjo është arritur mjaft mirë në komunën tonë.

Gjatë këtij viti kemi pasur raste emergjente në disa periudha, të reshura atmosferike bukur të shumta, mirëpo edhe pse ka pasur vërshime dëmet materiale kanë qenë të vogla. Duhet të theksojmë se disa pika të ndjeshme emergjente tanimë janë të zgjedhura si: ndërtimi i shtratit të lumit “Tërstena”, lumi “Podranqë” dhe disa pika më të vogla në territorin e komunës.

Për të gjitha punët tona të rregullta janë informuar në mënyrë të përhershme kryetari i komunës, strukturat tjera komunale dhe Departamenti i Emergjencave në Prishtinë.

Vërshime ka pasur edhe në toka pjellore ku janë krijuar dëme të konsideruara materiale në bujqësi, ky është një nga problemet që tani për tani e ngarkon situatën emergjente në komunë, dëmtimi i digave ku edhe vazhdon çdoherë e më tepër të krijojë mundësi që vërshimet të jenë më të mëdha. Andaj mendojmë se në të ardhmen kuvendi komunal së bashku me institucionet qendrore (Ministrinë e Ambientit), duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë rregullimit të digave të lumit “Silnica”. Viteve të fundit probleme janë duke krijuar shumë prroska në territorin e komunës, arsyeja e vërshimeve të këtyre prroskave është se banorët nuk janë të kujdesshëm në mirëmbajtjen, por përkundrazi hedhin mbeturina mbjellin shëlgje, uzurpojnë pjesë nga shtrati i përroskave, ku bëhet ngushtimi i shtratit e pastaj gjatë reshjeve uji del nga shtrati dhe vërshon në toka pjellore, oborre shtëpish dhe krijon dëme të mëdha materiale. Tani mendojmë se komuna duhet të ndërmarrë masa që të bëjë hapjen dhe zgjerimin këtyre prroskave.

Gjatë situatave emergjente Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim çdoherë është në gjendje gatishmërie të bëjë përcjelljen e situatës dhe të ndërmarrë aktivitete të nevojshme për tejkalimin e situatës.

Për zbutjen e kësaj situate janë angazhuar Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në tërheqjen (thithjen) e ujit nga bodrumet e shumë objekteve në qytet si dhe objekteve shkollore në terren. Prroi i Sfaraçakut, edhe më tutje mbetet për drejtorinë tonë si problem emergjent, për të cilin mendojmë se duhet sa më shpejt të rregullohet, sepse gjatë ngritjes së nivelit të ujit, uji mund të dalë në magjistrale dhe pengon qarkullimin e komunikacionit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka bërë identifikimin e pikave emergjente, caktimin e prioriteteve dhe koordinimin sa më efikas në mes të subjekteve për reagim të shpejtë, profesional dhe me efikasitet në raste të fatkeqësive natyrore, teknologjike etj, me qëllim të shpëtimit të jetës së njerëzve në radhë të parë, të mirave materiale dhe stabilizimin e situatës së krijuar gjatë dhe pas emergjencës.

DMSH-im në bashkëpunim me Qendrën Regjionale për Koordinim Emergjent ka punuar në mbledhjen e shënimeve për hartimin e planit dhe krijimin e bazës të të dhënave për rastet emergjente dhe fatkeqësive në komunë.

Kemi bashkëpunuar me të gjitha subjektet relevante, e në veçanti me subjektet emergjente në komunë ku në mënyrë të saktë janë mbledhur të dhënat e resurseve njerëzore dhe resurseve materialo-teknike që disponon komuna jonë.

Me këtë është arritur një shkallë më e lartë e harmonizimit të planeve për reagime emergjente.

Është bërë vizita në objekte të rrezikuara për banim, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit.

Kemi vizituar shumë raste të zjarreve të cilat kanë rrezikuar edhe objekte të banimit.

Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit ka arritur që çdoherë të jetë në gatishmëri dhe iu është përgjigjur kërkesave të popullatës në raste rrezikimi si: intervenimet në fikjen e zjarrit, shpëtimin e njerëzve dhe të mirave materiale, furnizimin me ujë dhe ndihma të tjera.

Për arsye të rasteve të shpeshta sidomos gjatë sezonit veror: qershor, korrik, gusht të intervenimeve në zjarre të hapura (fushor-malor). Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit ka qenë i obliguar që të bëjë mobilizimin e punëtorëve zjarrfikës për shuarjen e zjarreve në këto intervenime, ku sipas strukturës së zjarreve është intervenuar: në objektet ndërtimore 11 raste, (shtëpi, shtallë, kulm shtëpie etj.) në pajisje elektrike 15 raste (shtylla elektrike, kablllo etj.), në sipërfaqe të hapura 417 raste si (male, ushqim bagëtish, bari i tharë, amulllore etj.), në

automjete 8 raste kurse në zjarre të tjera 41.(mbeturina, kontejnera, goma etj).

Vlen të theksojmë se gjatë kësaj periudhe është intervenuar në (96 raste), për furnizim me ujë të pijshëm, pastrimi i rrugëve dhe shesheve, të gjitha këto me urdhër të personave përgjegjës të komunës.

Gjatë verës në këtë vitit problemet kanë qenë shumë të mëdha për shkak të temperaturave të larta, të cilat kanë dominuar gjatë tërë verës si dhe thatësisë së madhe. Gjatë këtyre muajve kemi pasur 596 intervenime prej të cilave 492 zjarre dhe 96 intervenime – furnizim me ujë për nevoja të qytetarëve.

Në këtë vit nga baza e Shërbimit të Zjarrfikësve kemi pasur dalje për intervenime:

- 867 për intervenim në të gjitha rastet
- 641 intervenime të zjarreve,
- 208 raste janë intervenime teknike,
- 7 raste aksidente rrugore
- 11 raste lajme të rrejshme.

Në të gjitha këto aktivitete janë angazhuar 1346 zjarrfikës me 453989 orë punë, si dhe 637 automjete të zjarrfikësve me 214.276 orë punë. Gjatë intervenimit përveç ujit, për fikjen e zjarrit janë përdorur edhe aparatet për shuarjen e zjarrit.

Përveç rasteve të zjarreve kemi pasur edhe intervenimet teknike si: kemi bërë nxjerrjen e disa të lënduarve nga rastet në aksidentet e komunikacionit rrugor, nxjerrjen e dy viktimave (trupave te pajetë), kemi bërë tërheqjen e automjetit privat të rënë në lumë në fsh. Pestovë te „ Ura e Pestovës”.

Në këtë vit kemi pasur zjarre të shprehura jashtëzakonisht shumë, ku dhe janë krijuar dëme shumë të mëdha materiale ku tani llogariten rreth: 300,000 €.

Ky vlerësim është sipas deklaratave të pronarëve të dëmtuar.

Siç shihet ky vit ka qenë me sfida të mëdha për DMSH-im dhe në veçanti për brigadën e zjarrfikësve. Me një angazhim permanent të kësaj drejtorie është arritur që shumë probleme të natyrave të ndryshme emergjente në mënyrë të suksesshme të zgjidhen, ndërsa në shumë raste të tjera të sanohen.

ZYRA KOMUNALE E ALARMIT DHE KOORDINIMIT EMERGJENT (ZAKE)

Kompetencat e komunës sipas nenit 31. të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë tjera, janë:

- Vështrimi, lajmërimi dhe alarmimi i popullatës për kërcënime rreziku,
- Organizimi-funksionimi i ndërlihdjeve për menaxhim në raste të situatave emergjente.

Zyra e Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent (ZAKE) në përputhje me obligimet që ka në këtë periudhë i ka përmbushur të gjitha detyrat;

Ka bërë hartimin dhe harmonizimin e planeve të ndërlidhjes për menaxhim në situata emergjente. Këto plane janë të aplikueshme dhe në çdo situatë emergjente mund ta kryejnë funksionin e paraparë.

Gjatë këtij viti, ZAKE ka kryer punë të rregullta në koordinimin e ndërlidhjeve, zbulimin dhe koordinimin e rasteve emergjente për të cilat rregullisht ka informuar në mënyrë permanente kryetarin e komunës, Departamentin e Emergjencave dhe Qendrën Regjionale për Koordinimin Emergjent në Mitrovicë, mbi ngjarjet dhe ecurinë e punëve në terren.

Zyra e Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent (ZAKE), gjatë kësaj periudhe ka bërë mirëmbajtjen e mjeteve teknike (servisimin, riprogramimin dhe rivendosjen e radiostacioneve nëpër pikat e parapara në terren.

Është mbajtur evidenca e prishjeve dhe janë ndërmarrë masa që mjetet të jenë përherë të afta për përdorim.

Janë mbajtur evidencat e të gjitha rasteve emergjente dhe janë bërë informatat e rregullta për secilin rast veç e veç për të gjitha organet kompetente.

Është hartuar plani financiar i shërbimeve dhe mallrave për furnizimin e drejtorisë për vitin 2012

OPERATIVA DHE PREVENTIVA

Gjendja e përgjithshme e mbrojtjes (parandalimit) nga zjarri në këtë qytet është bërë duke marrë parasysh (objektet vitale) edhe pompastacionet për furnizim të qytetarëve me derivate dhe gaz pothuajse është e mirë (e volitshme), pasi që ata i (kryejnë) evitojnë masat kryesore të parandalimit nga zjarri dhe e marrin shumë serioze (situatën) dhe 80% prej tyre i evitojnë mangësitë në objekte në afatin prej 15 ditësh deri në 30 ditë.

Problem në vete paraqesin tani ndërtimet e reja të cilat janë mbi katërkatëshe, ku ato ndërtohen në vende ku mundësia e intervenimit të shërbimeve emergjente është e vështirë dhe në disa raste e pamundshme, aty mungojnë daljet dhe shkallët emergjente, në hidrante mungon uji për intervenime etj. Të gjitha këto janë probleme të cilat tani e ngarkojnë situatën në përgjithësi për një preventivë më të suksesshme në momentin e duhur.

Gjendja në objekte banimi e sidomos ato të vjetra të ndërtuara para 30-40 vitesh, tregon se nuk kanë hidrant, ujë të pijshëm, nuk ka rregull dhe askush nuk interesohet për mirëmbajtjen e tyre (mure të

përlyera, nuk ka dritë në korridore, rryma nuk është në nivel)etj. Nuk ka shtëpiak dhe nuk ke kujt t'i drejtohesh rreth problemeve që paraqiten nëpër objekte..

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Naim Hyseni

Lekturoi: Vlora Krasniqi